




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 112/02-7632
Datë: 27.03.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në neni 60 paragrafi 60.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil (KPSHC) për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Zyrtar për Menaxhim të Mbeturinave

Përbërja e KPSHC-ës është:

1. Leke Sina - Kryesues i Komisionit (Udhëheqës i Sektorit për Komunikacion)
 2. Frrok Gjergjaj - anëtare (Udhëheqës i Zyrës Ligjore, u.d.)
 3. Armend Behluli - anëtar (Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim)
 4. Arber Gola - anëtar (Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian)
 5. Lumni Shllaku - anëtare (Zyrtare për Barazi Gjinore)
2. KPSHC fillon punën e shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur, menjëherë pas mbylljes së konkursit, dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit.

A r s y e t i m

Komisioni në përbërje sipas pikës dy të këtij vendimi është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, përcaktimin e orarit të përzgjedhjes, mbajtjen e testeve të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshëm.

Me qëllim të rrespektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë vend të punës, u caktua komisioni si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të KPSHC-ës
- Zyrës së Personelit
- Arkivit.



Kryetari i Komunës së Gjakovë

Ardian Gjini